27-03-2015

Të nderuar redaktorë,

Gjatë viteve të kaluara, ju keni pranuar komunikata për shtyp të EULEX-it rreth lëndëve në gjykata dhe prokurori ku kanë qenë të përfshirë gjyqtarët apo prokurorët e EULEX-it. Po ashtu, ju keni shqyrtuar me kujdes punën e EULEX-it duke i adresuar pyetje zyrës së EULEX-it për informimin e shtypit dhe publikut. Ne ju përgëzojmë për qasjen tuaj proaktive gjatë viteve të fundit duke i kërkuar llogari si EULEX-it ashtu edhe gjyqësorit të Kosovës.

Me Shkëmbimin e Letrave ndërmjet Presidentes së Kosovës dhe Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe Siguri, të ratifikuar nga Kuvendi i Kosovës në prill të vitit 2014, gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it tani formalisht janë integruar në institucionet e Kosovës.

Misioni i EULEX-it, Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës kanë rënë dakord se kjo epokë e re e partneritetit dhe vullneti i shprehur i autoriteteve të Kosovës për të marrë më shumë përgjegjësi, duhet gjithashtu të pasqyrohen edhe në komunikimin me publikun.

Kemi kënaqësinë që t'iu njoftojmë se tani e tutje institucionet e Kosovës do të jenë përgjegjëse për t'iu informuar juve dhe publikun e gjerë për aktivitetet e gjyqësorit të Kosovës. Gjykatat dhe prokuroritë tani kanë caktuar zyrtarët për shtyp, pikat e kontakteve të të cilëve mund të gjenden në shtojcë. Ju lutemi që pyetjet rreth gjykatave dhe prokurorive t'i drejtoni drejpërdrejt tek ata. Do të jetë përgjegjësi e tyre për të raportuar në mënyrë proaktive. EULEX-i do t'i ri-orioentojë gazetarët, të cilët kërkojnë informacion mbi lëndët individuale në gjykata apo prokrurori, tek institucionet përkatëse të Kosovës. Në mënyrë të ngjashme, EULEX-i do të lëshojë njoftime për shtyp vetëm në raste të jashtëzakonshme.

Ne shpresojmë që ju do të na shoqëroni në këtë përpjekje të re me të njëjtin qëndrim që keni treguar edhe në të kaluarën, duke mbështetur KGJK-në dhe KPK-në, si dhe gjykatat dhe prokuroritë në shtimin e përpjekjeve të tyre të komunikimit publik dhe të qenit të përgjegjshëm ndaj juve dhe publikut të gjerë.

EULEX-i do t'i ndihmojë institucionet e Kosovës në përpjekjet e tyre për informimin e publikut. EULEX-i do të vazhdojë të komunikojë me juve dhe publikun e gjerë, duke i shpjeguar aktivitetet dhe objektivat e Misionit. Megjithatë, një komunikim i tillë nuk do të hyjë më në hollësitë e lëndëve individuale të gjykatave apo të prokurorive. Gjithnjë e më shumë, ju do të shihni "më pak EULEX" dhe "më shumë Kosovë".

Gabriele Meucci	Enver Peci	Sylë Hoxhaj
Shefi i Misionit të EULEX-it	Kryesuesi i KGJK-së	Kryesuesi i KPK-së

Bashkëngjitur: detajet e kontaktit me zyrtarët e shtypit